



REPUBLIKA E SHQIPERISE

GJYKATA E ADMINISTRATIVE E SHKALLES SE PARE TIRANE

Numri i Ceshtjes : 31154-06386-80-2017 Data e Regjistrimit : 20/10/2017
Numri i Vendimit: 80-2018-4016 Data e Vendimit : 31/10/2018

VENDIM

NE EMER TE REPUBLIKES

GJYKATA E ADMINISTRATIVE E SHKALLES SE PARE TIRANE E PERBERE NGA:

GJYQTAR: {...}

SEKRETARE: {...}

Sot me date 31/10/2018 mori ne shqyrtim ne seance gjyqesore ceshtjen civile qe i perket :

Padites {...} Production sh.p.k I Paditur Drejtoria e Pergjithshme e Markave dhe Patentave

Objekti:1- Shfuqizimin e aktit administrate vendim nr. 618 me 15.08.2017 te bordit te apelimit prane drejtorise se pergjithshme te patentave. 2- Detyrimin e DPPM qe te regjistroje marken trcgetare "{...}" me numer aplikimi AL/T/2016/618 aplikuar me 29.07.2016, publikuar me 06.09.2016.

Baza Ligjore:Neni 143/1, neni 143/5.b neni 150 neni 150/a i ligjit te pronesise industriale nr. 9947 dt. 07.07.2008 per pronesine industriale i ndryshuar. Neni 6 bis i konventes se Parish per mbrojtjen e pronesise industriale dt 20.03.1883. Kodi i procedures administrative te Shqipcrise

Perfundimisht,per te gjitha sa u analizuan me siper gjykata vlereson se padia e paditesit LaVitta Production eshte e pabazuar neligj dhe ne prova dhe si e tille ajo duhet te rrezohet.

VFRFN ·

Veren: Ne perfundim te shqyrtimit gjyqesor te kesaj geshtjeje, Gjykata, si analizoi provat e paraqitura nga palet dhe te administruara gjate gjykimit; si u konsultua me ligjin e aplikueshem per rastin; dhe, si degjoi pretendimet perfundimtare te paleve ndergjygjese te cilat respektivisht kerkuan:

Pala paditese: pranimin e padise sipas objektit Pala e paditur: rrezimin e padise Nderhyresi dytesor: rrezimin e padise;

VEREN:

i. Rrethanat e faktit

Pala paditese "{...} Production sh.p.k", eshte person juridik i se drejtes tregtare shqiptare me forme ligjore te organizimit te saj, shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, me zyre qendrore te saj me seli ne Tirane, Dajt, Lanabregas.

Shoqeria "{...} production" shpk ka depozituar nje aplikim kombetar me nr.AL/T/2016/619 prane Drejtorise se Pergjithshme te Pronesise Industriale (asokohe D. e Pergj e Markave dhe Patentave) per regjistrimin e markes "{...}" si fjale dhe figure ne dt 29.07.2016 ne klasen 32 dhe pas plotesimit te kushteve formale te aplikimit eshte pajisur me deshmi depozitimi qe mban daten 16.08.2016.

Shoqeria "{...}" S.P.A. ka paraqitur prane Bordit te Apelimit ne DPPI, kerkesen per kundersiztim ndaj markes "{...}" (fjale e figure) me numer aplikimi AL/T/2016/618, te depozituar nga shoqeria "{...} production" shpk.

Bordi i Apelimit i Drejtorise se Pergjithshme te Pronesise Industriale, pasi diskutoi lidhur me pretendimet dhe dokumentet e paraqitura nga palet, si dhe bazuar ne parashikimet e neneve 143, 152, 153 si dhe 175 te Ligjit Nr. 9947, date 07.07.2008 "Per Pronesine Industriale"(i ndryshuar) dhe Kreut VI te VKM Nr. 1706, date 29.12.2008 (i ndryshuar), ka konstatuar se:

Personi i trete e ka paraqitur kerkesen per kundersiztim brenda afatit ligjor te percaktuar nga nenet 143 dhe 152 te Ligjit Nr. 9947 date 07.07,2008 i ndryshuar, si dhe pretendimin se marka e kundersiztuar shkel te drejtat e tij te meparshme, e ka bazuar ne parashikimet e shkronjes "g", te pikes 5, te nenit 143, te Ligjit Nr. 9947 date 07.07.2008. Bordi ka vleresuar se marka e kundersiztuar, demton reputacionin dhe emrin e mire te markes te pales kundersiztuese, emer ky qe per arsyet e siperpermendura konsumatori e asocion me shoqerine kundersiztuese "{...} S.P.A."

Per sa me siper, Bordi i Apelimit te DPPI, me vendimin nr.618/7 prot. date 15.08.2017 ka vendosur pranimin e kundersizimit te regjistrimit te markes "{...}" (fjale e figure), me nr. aplikimi AL/T/2016/618 si dhe refuzimin e regjistrimit te markes "{...}" (fjale e figure), me nr. aplikimi AL/T/2016/618. Sakaq, me vendimin nr.619/7 prot date 15.08.2017 ka vendosur pranimin e kundersizimit te markes "{...}" (fjale) me nr.aplikimi AL/T2016/619 si dhe refuzimin e regjistrimit te markes "{...}" (fjale) me nr.aplikimi AL/T/2016/619.

Duke mos qene dakord me veprimtarine administrative te pales se paditur DPPI dhe duke i konsideruar aktet adminisitrative ai te marra ne kundersiztim me ligjin dhe procedurat dhe te pabazuar ne prova, pala paditese i eshte drejtuar Gjykates Administrative te Shkalles se Pare Tirane me padine sipas objektit te mesiperm.

ii. Pretendimet dhe prapesimet e paleve

Pretendimet e pales paditese:

- Rezultati i shqyrtimit paraprak ne lidhje me te drejtat e meparshme ka rezultuar dhe rezulton ne favor te aplikantit dhe kjo justifikon legjitimitetin e tij per te aplikuar per mbrojtjen e markes tregtare. Eshte qartesisht e dukshme se aplikanti {...} Production sh.p.k eshte zoterues i ligjshem i nje te drejte te meparshme mbi marken tregtare "{...}" duke qene se ka nje numer dhe date aplikimi me te hershme se ankimesi ne Republiken e Shqiperise. Si rrjedhim nuk rezulton e regjistruar asnje marke ne klasen 32 identike me marken e kundershuar {...}.Kundershtuesi e mbeshtet mbrojtjen ne lidhje me marken ne nenin 156/5 te ligjit te pronesise industriale ne lidhje me te drejtat qe rrjedhin nga statusi i markes se mirenjohur te drejta qe i njihen edhe pronarit te nje marke te mirenjohur kur marka eshte e paregjistmar.
- Per vleresimin e reputacionit te nje marke rendesi te vegante kane kriteret e percaktuara nga Udhezimet e WIPO ne lidhje me kundershimin e markave, dhe veganerisht pjesa qe trajton mnarkat e mirenjohura. Ne shqyrtimin e kundershimeve inter partes DPPI eshte e kufizuar vetem ne shqyrtimin e fakteve, deshmive dhe argumentet te dhena nga palet. Ne vleresim te ketyre fakteve zyra nuk zhvillon nje hetim ex-ufficio, por duhet vetem bazoje gjykimin e saj vetem ne lidhje me informacionet dhe provat e paraqitura nga ana e kundershuesit.
- Se pari: Kundershtuesi pretendon se marka qe gezon statusin e markes se mirenjohur eshte perdorur ne Shqiperi qe nga viti 2012 dhe ka nje rritje progresive te te ardhurave dhe volumit te shitjeve por dokumenti me i rendesishem provues ne kete rast qe eshte kontrata me shperndaresin ekskluziv Eurolab International Group shpk nuk permban daten ne te cilen kjo kontrate eshte lidhur apo ka filluar efektet e saj gje qe e ben te veshtire provimin e vertetesise se saj.
- Se dyti: Nje tjetër kriter i rendesishem ne vleresimin e statusit te markes se mirenjohur eshte edhe reklamimi dhe publiciteti. Ne udhezimin e WIPO-s te vitit 2004 ne lidhje me kriteret e vleresimit te markave ky kriter, pra reklamimi dhe publiciteti, zene nje vend te rendesishem menjehere pas anketimeve nga burime te pavarura dhe faturave apo pasqyrave financiare nga etnitete te pavarura audituese. Ne kete rast provat e paraqitura nga kundershuesi konsistojne ne nje liste me aktivitete sportive te cilat jane zhvilluar brenda territorit te shtetit Italian dhe kryesisht ne Rome, Capri, Milano. Ne kete kuptim ato jane te izoluara brenda nje territori gjeografik te kufizuar te shtetit te origjines, Italise dhe i jane ekspozuar nje pubiiku relativisht te gjere brenda ketij territori por gjithesesi te kufizuar.
- Se treti: Nje argument tjetër referuar mungeses se lidhjes mes ketyre ekspozimeve publike te markes kundershuese eshte fakti se ato jane ekspozime te markes {...}dhe jo markes {...}. Si rrjedhim provat faktike dhe reale per sa i perket reklamimit, publicitetit dhe ekspozimit te markes brenda territorit te Republikes se Shqiperise mungojne. Marka kundershuese eshte nje nen-marke e re e krijuar per nje game produktesh te ndryshme nga ato te meparshme te markes {...}. Ndaj edhe reputacioni i markes {...} (marka kundershuese) duhet te shqyrtohet si i pavarur nga ai markes se mirenjohur {...}. Bashkelidhja e te dy markave pavaresisht politikave te marketingut te kompanise nuk eshte prove e mjaftueshme qe marka {...} ka po ate shkalle reputacioni dhe statusin e markes se mirenjohur sikurse marka kryesore. Kerkojme pranimin e padise.

Prapesimet e pales se paditur Drejtoria e Pergjithshme e Pronesise Industriale:

- Bordi i Apelimit i DPPI e perqendroi diskutimin ne keto geshtje kryesore:ngjashmerine mes shenjave qe perbejne markat si dhe mallrave te cilat ato identifikojne ne treg; ekzistencen e mundesise qe te shkaktohet konfuzion tek konsumatori ose bashkelidhje mes markave per shkak te ngjashmerive te mesiperme.Bordi ka konstatuar se:- Shenjat ne konflikt jane identike ne se marrim parasysh se forma e shishes ne te cilen eshte ambalazhuar produkti i kundershuesit eshte element i pambrojtshem, pasi jo vetem qe nje forme e tille shisheje per lengje eshte kthyer ne nje praktike te zakonshme ne treg, por

eshte gjithashtu nje forme e domosdoshme per te realizuar nje rezultat teknik, sikurse parashikohet ne shkronjat “c” e “g”, te pikes 1, te nenit 142, te ligjit “Per pronesine industriale” i ndryshuar.-Mallrat ne diskutim rezultojne gjithashtu identike.

- Personi i trete, shoqeria “{...} S.P.A.”, ne kohen kur eshte aplikuar per regjistrimin e markes se kundershuar “{...}”, ka qene pronar i se njejtës marke identike {...} te regjistruar ne Itali. Ai ka argumentuar dhe vertetuar me ane te provave te shumta te depozitura ne kete procedure kundershimi, se kjo marke eshte perdorur intensivisht ne Shqiperi dhe per kete arsye ajo ka fituar reputacion dhe emer te mire tek konsumatori shqiptar. Bordi i Apelit i DPPI ka vleresuar se kjo ka ndodhur edhe per fakt se produktet “{...}” te pales kundershuese kane fituar reputacion, perveg se per shkak te shpërndarjes se gjere te tyre ne shume pika shitjeje, por edhe sepse tashme eshte fakt qe produktet ushqimore “{...}” bashke me ato si “{...}”, “{...}” etj., jane nga produktet italiane me me fame ne Shqiperi, pra nga me te njohurat per konsumatorin, per shkak te cilesise qe ofrojne, por dhe te kohes se gjate ne te cilen jane prezente ne tregun shqiptar. Pra, marka {...} lidhet ne perceptimin e konsumatorit ne menyre te drejtperdrejte me shoqerine kundershuese “{...} S.P.A.”. Nje element i rendesishem per t’u konsideruar jane kanalet e shpërndarjes se mallrave, objekt shqyrtimi. Ato jane baret e lokalet e ndryshme, dyqanet dhe supermarketet etj., ku mallrat per te cilat kerkojne te regjistrohen markat, jane sistemuar ne te njejtat rafte apo sektore dhe rrjedhimisht, ne keto kushte, rritet mundesia per konfuzion te shenjave dalluese (markave).

- Bazuar ne faktet e mesiperme, Bordi ka vleresuar se marka e kundershuar, demton reputacionin dhe emrin e mire te markave te pales kundershuese, emer ky qe per arsyet e siperpermendura konsumatori e asocion me shoqerine kundershuese “{...} S.P.A.” Per keto arsye, Bordi i Apelit te DPPI, ne baze te neneve 143, 152 e 153 te Ligjit Nr. 9947 date 07.07.2008, «Per Pronesine Industriale», si dhe te pikes 2.6, te Kreut VI, te VKM Nr. 1706, date 29.12.2008, «Per Miratimin e Rregullores per Regjistrimin e Markave Tregtare dhe te Sherbimit», e ndryshuar, ka vendosur pranimin e kundershimit te regjistrimit te markes “{...}” (fjale e figure), me nr. aplikimi AL/T/2016/618 si dhe refuzimin e regjistrimit te markes “{...}” (fjale e figure), me nr. aplikimi AL/T/2016/618. Si perfundim, kerkojme nga Gjykata rrezimin e Kerkese - Padise , lenien ne fuqi Vendimin e Bordit te Apelit dhe refuzimin e regjistrimit te markes “{...}” (fjale e figure) , me nr. aplikimi AL/T/2016/618, me aplikant {...} Production sh.p.k.

Prapesimet e nderhyresit dytesor {...} S.p.A.:

- Sipas neneve 156 (4), 143 (5) (g) te ligjit specifik, si dhe neni 6 bis te Konvenes se Parisit “Per mbrojtjen e Pronesise Industriale” pronari i nje marke te mirenjohur por te paregjistruar ne Shqiperi gezon te njejtat te drejta si pronari i nje marke te regjistruar, cka do te thote, ka te drejte te kundershtojte nje marke te mevonshme (ne faze aplikimi, apo dhe pas regjistrimit).

- Pjesa e kerkimit te lidhur me vendimin Nr.619/7 date 15 Gusht 2017 te Bordit te Apelit eshte parashkruar, dhe padia ne lidhje me kete kerkim duhet te rrezohet.

- Ne themelin e kerkimeve te paditesit qendron pretendimi se marka jone nuk ploteson kriteret ligjore per tu vleresuar si e mirenjohur. Paditesi ve theksin tek aplikimi i kriterëve te vendosura nga Zyra Nderkombetare e Pronesise Intelektuale (WIPO) ne dokumentin e titulluar “Rekomandime te Perbashketa Per Mbrojtjen e Markave Te Mirenjohura” leshuar ne Shtator 1999. Sipas paditesit, Bordi nuk i ka analizuar keto kriterë, por sic do ta trajtojme me poshte, ne provojme katerciperisht permbushjen e ketyre kriterëve, duke provuar gjithashtu sa te pambeshtetura jane pretendimet e paditesit. Dhe ne kete aspekt, praktika shqiptare nuk ofron ndonje larmishmeri. Megjithate, ajo orienton

paditesit. Dhe ne kete aspekt, praktika shqiptare nuk ofron ndonje larmishmeri. Megjithate, ajo orienton tek manuallet e hartuara nga WIPO te cilat permbajne kritere (te elaboruara) te cilat duhet te mbahen parasysh ne vleresimin e nje marke si te mirenjohur -shih per kete efekt vendimi gjyqesor Nr.5796, date 1 Korrik 2011 dhene nga Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane per markat {...} vs. {...} jane ne fuqi nga Gjykata e Apelit Tirane.

- Kohezgjatja, shtrirja dhe gjeografia e perdorimit jane faktore shume percaktues ne vleresimin nese nje marke eshte e mirenjohur apo jo. Gjithashtu, perdorimi i markes ne vende kufitare, ne ne territore ku fiitet e njejta gjuhe, ne territore te ciat mbuiohen nga e njejta media (television, apo media te printuara) apo ne territore te cilat kane marredhenije te ngushta tregtare mund te merren gjithashtu ne konsiderate (pika 2.4 e shpjegimeve shoqeruese); Termi 'tperdorim,' nuk eshte i percaktuar. Ne nivel kombetar apo rajonal, geshtja e asaj se cfare konsiderohet perdorim i nje marke zakonisht lind ne kontekstin e pervetesimit te se drejtave te markes permes perdorimit, pavlefshmeria e regjistrimeve per mos- perdorim, apo e fitimit te karakterit dallues permes perdorimit. Megjithate, per qeime te ketyre dispozitave, termi "perdorim" mbulon gjithashtu perdorimin e nje marke ne internet (pika 2.5 e shpjegimeve shoqeruese); Reklamimi, psh, ne shtyp ose media elektronike (perfshire edhe Internet) eshte nje forme promovimi Nje tjetër shembull i reklamimit eshte reklamimi apo tregtimit te produkteve ne ekspozita dhe panaire {pika 2.6 e shpjegimeve shoqeruese}; Prova ne lidhje me rastet e sukseshme ne zbatueshmerine e te drejtave te markes, jane po ashtu nje faktor qe duhet te mbahen parasysh ne nje vleresim te tille. Ketu perfshijne si ceshtjet e sukseseshme te fituara ne vendin perkates (te zgjidhura me gjykate/organ administrative apo me marreveshje) ashtu dhe ne vende kufitare (pika 2.8 e shpjegimeve shoqeruese). Vlera e markes. Keto ka nje pafundesi metodash per te vleresuar kete tregues. Gjithesesi dokumenti nuk percakton metodat e vleresimit, ky dokument vetem nenvizon rendesine e ketij faktori ne vleresimin nese nje marke eshte e mirenjohur apo jo {pika 2.9 e shpjegimeve shoqeruese}. Megjithate praktika mban parasysh disa kritere ne vleresimin e ketij kriteri, si psh cmimet, certifikatat apo instrumentet e ngjashme te njohjes publike ne lidhje me cilesine e produkteve, apo performance e markes (ky faktor permendet nga Gjykata ne '{...} Meyer' dhe {...}) apo fakti qe nje marke kerkohet nga kompanite e treta per riprodhimin e prodhimeve te tyre, qofte si nje shenje tregtare, ose si zburim i thjeshte, eshte nje tregues i forte se shenja ka nje shkalle te larte atraktiviteti dhe nje vlere te rendesishme ekonomike. Prandaj, shkalla ne te cilen shenja eshte shfrytezuar permes licencimit, tregtimit dhe sponsorizimit, si dhe rendesia e skemave perkatese, jane indikacione te dobishme ne vleresimin e reputacionit. Ky faktor permendet ne Nenin 2 (1) (b) (6) te Rekomandimeve te WIPO-s.

- Provohet katerciperisht dijenia e aplikantit per te drejtat e kompanise {...}mbi marken {...} {...}dhe rrjedhimisht keqbesimi i tij ne aplikimin e markave {...} fjale/ fjale &figure.Permbushja e keqbesimit ne rastin konkret perben nje tjetër shkak ligjor (te pavarur nga ai i parashkrimit dhe statusit te markes {...} {...}si te mirenjohur) per rrezimin e padise.Si perfundim, per sa u provua me siper, padia eshte e pambeshtetur ne ligj dhe prova, ajo gjithashtu eshte parashkruar. Per sa me lart, kerkojme rrezimin e plote te padise, duke lene ne fuqi vendimet nr.618/7 dhe 619/7 date 15 Gusht.

iii. Vleresimi i Gjykates

Lidhur me kushtet formale te marrjes ne shqyrtim te kerkesepadise dhe aspekte proceduriale ?Bazuar ne dispozitat te ligjit me Nr.49/2012, nenet 7, 8, 10/1 dhe neni 11/1, referuar objektit, shkakut ligjor dhe pales se paditur te thirrur me ane te padise ne kete gjykim, kjo gjykate eshte kompetente per

gjykimin e padise. Gjykata cmon se jemi para dy akteve mirefilli administrative te organit publik shteteror pale e paditur, Drejtorise se Pergjithshme te Pronesise Industriale (ne vijim DPPI) pra perpara nje forme vullneti materializuar nepermjet “ aktit administrate” , ne kuptim te nenit 2, pika 2 te ligjit organik 49/2012. Per rrjedhoje, kjo gjykate eshte kompetente per shqyrtimin e kesaj padie.

?Padia administrative si eshte regjistruar ne Gjykate, eshte caktuar me short elektronik te gjykohet si gjyqtar kryesues prej ketij trupi gjykues. Trupi gjykues per gjykimin e padise u formua ne zbatim te nenit 12 paragrafi i pare te ligjit, me Nr.49/2012 “Per gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarreshjeve administrative”.

?Proceduralisht pala paditese ka legjitimitet aktiv ne ngritjen e kesaj padie pasi ka interes te ligjshem. Ligji nr. 49/2012 “Per gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarreshjeve administrative”, parashikon se: “Te drejten e ngritjes se padise e ka cdo subjekt, qe pretendon se i eshte cenuar nje e drejte apo nje interes i ligjshem nga nje veprim apo mosveprim i organit publik” (neni 15/a). DPPI eshte organ publik ne kuptim te nenit 2, pika 6 te ligjit nr 49/2012 dhe veprimtaria e tij administrative lidhet me nxjerrjen e akteve administrative ne fushen e pronesise industriale Kesisoj, edhe i padituri ka legjitimitet pasiv.

?Bazuar ne nenet 16 te ligjit nr 49/2012, paditesi legjitimohet ne ngritjen e kesaj padie pasi nuk ka pasur detyrimin per rekurs administrativ ne baze te ligjit te posacem per Pronesine Industriale, keshtuqe ai legjitimohet t’i drejtohet drejtperdrejt kesaj gjykate. Po ashtu, ne referim te nenit 18 te ligjit nr.49/2012 pala paditese eshte brenda afateve procedurale per te kerkuar shfuqizimin e akteve administrative objekt gjykimi. Kunder vendimeve/akteve administrative nr. 618/7 dhe 619/7 te dates 15.08.2017 pala paditese ka marre dijeni me 20.09.2017. Sakaq, padia eshte paraqitur me 20.10.2018 dhe kuptohet se eshte brenda afatit ligjor te parashikuar nga ligji i posacem, neni 184/g qe ka perparesi zbatimi para afatit ligjor 45 ditor te parashikuar ne nenin 18 te ligjit nr.49/2012 per atakimin e tyre ne gjykate.

?Gjykata me qellim mbrotjen dhe perfaqesimin ne gjyq te interesave te shtetit, njoftoi edhe Avokaturen e Shtetit, ne perputhje me nenin 79/a te KPrC-se, e cila me shkrese delegoi te drejten e perfaqesimit dhe mbrotjes.

?Ne seancat per veprime pergatitore, pala paditese kerkoj te rregullonte ndergjygesine ne drejtim te te paditurit i cili nuk eshte me nen emertimin Drejtoria e Pergjithshme e Markave dhe Patentave por funksionon nen emertimin Drejtoria e Pergjithshme e Pronesise Industriale. Kesisoj, Gjykata me vendim te ndermjetem, bazuar ne nenet 2 te KPrC-se ne lidhje me nenin 199 te tij, pranoi kerkesen e pales paditese per te bere kalimin procedural nga DPPM ne DPPI.

?Po me kerrese me shkrim, pala paditese i kerkoj gjykates te shtonte objektin e padise duke kerkuar krahas shfuqizimit te aktit administrativ nr.618/7 date 15.08.2017 edhe shfuqizimin e 619/7 prot date 15.08.2017. Duke qene se eshte e drejte e pales paditese qe te shtoje, pakesoje apo ndryshoje objektin e padise, pa ndryshuar shkakun ligjor te saj, e pranoi kete kerkim bazuar ne nenin 185 te KPrC-se.

?Gjithashtu, pergjate gjykimit ne veprime pergatitore, u paraqit edhe nje kerrese per nderhyrje dytesore nga subjekti {...} spa, per t’i u bashkuar pales se paditur DPPI ne gjykim. Gjykata, me vendim te ndermjetem, pasur parasysh faktin se vendimet e kundershutuara ne padi jane produkt i procedurave administrative te mbajtura prane Bordit te Apelimit te DPPI-se dhe keto procedura kane qene iniciuar nga vete nderhyresi dytesor {...} s.p.a si subjekti qe ka kundershtuar regjistrimin e markes se paditesit {...} Production, me vendim te ndermjetem, bazuar ne nenet 191 dhe 194 te KPrC-se e pranoi kete kerrese per nderhyrje dytesore te kerkuesit.

?Me pas gjykimi vijoi e u mbyll midis ketyre paleve ndergjygjese si dhe me ate objekt e baze ligjore sikurse eshte parashtruar ne pjesen hyrese te ketoj vendimi.

Meqenese, gjykata arriti ne perfundimin si me lart, mbi elementet formalo-thelbesore te padise, merr ne vleresim bazueshmerine ne ligj dhe ne prova te pretendimeve te ngritura ne padi, si me poshte:

Bazueshmeria ne ligj dhe ne prova e pretendimeve te ngritura ne kerkese-padi

Gjykata, si shqyrtoi aktet ne dosje dhe u konsultua me ligjin cmon se pretendimet e ngritura ne padi jane teresisht te pabazuara ne ligj e prova e si te tilla duhen rrezuar. Ne kete konkluzion ky trup gjykues arrin persa vijon me poshte me kete arsyetim:

Gjykata, si fillim, cmon te theksoje se ngritja e padise ne kuptim te Nenit 16, 17 te ligjit nr.49/2012 qe perfshihet ne bazen juridike te kerkespadise qe po shqyrtojme, kerkon plotesimin njekohesisht te tre kushteve: (1) te kemi nje akt administrativ (2) ky akt te jete i paligjshem dhe (3) nga kjo paligjshmeri paditesit t'i jene cenuar drejtperdrejt apo terthorazi, te drejtat subjektive apo interesat legjitime.

Sa i takon pikes se pare, Gjykata vlereson se kusht i domosdoshem qe nje akt administrativ te krijoje efektet juridike eshte vlefshmeria e tij. Ligji detyron organet e administrates publike te respektojne urdherimet e tij, me qellim qe aktet e nxjerra prej tyre te sjellin pasojat e deshiruara ligjore. Mosrespektimi apo injorimi i ketyre urdherimeve te ligjit passjellin pasojen e paligjshmerise se aktit. Mjafton shkelja e njeres prej tyre per te zhvleresuar aktin ne teresine e tij. Elementet e vlefshmerise se aktit administrativ jane kater . Ato jane:

- (i) kompetenca (neni 22 i KPA-se);
- (ii) procedura (neni 33 e ne vijim te KPA-se);
- (iii) perputhja e aktit me permbajtjen e ligjit (neni 4 i KPA-se);
- (iv) perputhja e aktit me qellimin e ligjit (neni 11, 12 etj te KPA-se).

(i.a)Me kompetence kuptohet e drejta dhe detyra e nje organi te administrates publike per te ushtruar veprimtari ne baze dhe ne zbatim te ligjit. (ii.a)Procedura qe duhet te ndiqet per nxjerrjen e nje akti administrativ percaktohet nga natyra dhe forma e aktit, si dhe nga struktura dhe vendi qe ze organi administrativ ne sistemin e pergjithshem te hierarkise shteterore. Ajo ndahet ne tri faza: ne proceduren paraprake, ne proceduren gjate nxjerrjes se aktit dhe procedura pas nxjerrjes se aktit. Te gjitha keto faza procedurale duhet te respektohen, per aq sa ligji i posagem nuk ka parashikuar ndryshe. Ne rast te kundert akti administrativ i nxjerre ne kundersiztim me keto faza procedurale behet i pavlefshem.

(iii.a)Karakteri nenligjor i aktit administrativ eshte nje nder vegorite e tij kryesore. Ai duhet t'i referohet ne gdo rast kerkesave te ligjit me qellim qe ne asnje rast mos te vije ne kundersiztim apo ta tejkalojte ate.

(iv.a)Nepermjet aktit administrativ realizohet krijimi, ndryshimi apo shuarja e nje marredhenieje juridike te caktuar. Pikerisht, ky qellim, qe kerkohet te arrihet nepermjet aktit administrativ duhet domosdoshmerisht te perputhet me qellimin e vete ligjit. Te kater elementet qe karakterizojne vlefshmerine e aktit administrativ kane rendesi percaktuese per te vleresuar ligjshmerine e tij. Asnje prej ketyre kriterëve nuk mund te marre perparesi per arsye te konkurrimit me njeri-tjetrin. Mosrespektimi i ketyre kriterëve/elementeve te vlefshmerise se aktit pasjellin pavlefshmerine e tij, e cila per nga forma e rendesise se shkeljes ndahet ne pavlefshmeri absolute apo pavlefshmeri relative (anulim/shfuqizim). Rasti i pare, do te jemi perballe gjendjes se pavlefshmerise absolute te aktit administrativ ne rastin kur kemi mungese te plote te veprimit juridik nga akti. Akti i vesuar me pavlefshmeri absolute qe nga momenti i nxjerrjes se tij nuk krijon dhe as nuk mund te krijojte pasoja juridike. Ai eshte nje nulitet i plote dhe nuk mund te kete kurrefare fuqie. Neni 108 i KPA-se sanksionon qarte rastet kur jemi perpara nje

akti administrate absolutisht te pavlefshem (shkelje flagrante e ligjit sic jane lidhur me i) kompetencen e organit publik; ii) proceduren e nxjerrjes se tij; ose iii) formen ose elemente te tjere te detyrueshem te aktit; b akti eshte nxjerre si pasoje e dhunes, kanosjes, mashtrimit; ekzcutimi perben veper penale; rastet te tjera te parashikuara ne ligj).

Rasti i dyte, do te jemi perballe nje akti administrativ te pavlefshem relativisht kur shkalla dhe dimensionet e shkeljes se kritereve te vlefshmerise se aktit nuk jane ne nivelin e pavlefshmerise absolute (nivele me i larte dhe flagrant i shkeljes). Per keto arsye, keto akte administrative per aq kohe sa nuk eshte bere ankim administrativ apo gjyqesor brenda afateve te caktuara nga ligji ose nuk eshte revokuar apo shfuqizuar kryesisht nga organi qe e ka dhene apo organi me i larte administrativ, vazhdojne te prodhojne pasoja ligjore. Per aq kohe sa ai nuk anulohet apo shfuqizohet, ai vazhdon te prodhoje pasoja juridike per subjektin e interesuar. Kodi i Ri i Procedurave Administrative e parashikon rastin e pavlefshmerise relative ne nenin 109, ne kuadrin e paligjshmerise se aktit (shkelen normat ligjore; shkelen normat ligjore persa i perket formes se aktit administrativ, shkelet parimi i proporcionalitetit; vjen ne kundërshtim me ligjin material; eshte shkelur e drejta e diskrecionit). Nese keto raste konstatohen nga Gjykata, ajo me vendim vendos shfuqizimin/anulimin e vendimit administrativ perkates. Pasojat e nje shfuqizimi/anulimi te tille do te jene prapavepruese (ex tunc), prej momentit fillestar kur eshte aprovuar akti (neni 113§2 i KPA-se).

Duke u rikthyer te geshtja konkrete, Gjykata vlereson se aktet administrative ne trajten e vendimeve te nxjerra prej Bordit te Apelimit te DPPI nr. 618/7 dhe 619/7 date 15.08.2017 me te cilat Bordi ka vendosur pranimin e kundërshtimit te regjistrimit te markes "{...}" (fjale e figure), me nr. aplikimi AL/T/2016/618 si dhe refuzimin e regjistrimit te markes "{...}" (fjale e figure), me nr. aplikimi AL/T/2016/618 dhe pranimin e kundërshtimit te regjistrimit te markes "{...}" (fjale) me nr. Aplikimi AL/T/2016/619 dhe refuzimin e regjistrimit te saj jane te bazuar ne ligj e prova, nuk kane arsye shfuqizimi e si rrjedhoje padia duhet rrezuar. Ne kete konkludim, Gjykata arrin per arsyet e poshteshenuara:

Se pari, ky trup gjykues e gjen te pabazuar pretendimin e nderhyresit dytesor « {...} s.p.a» se, duke mbajtur parasysh daten e marrjes dijeni prej pales paditese te vendimit - 20 Shtator 2017, dhe daten e disponimit te ketij kerkimi - 30 Maj 2018 me kerkese per shtim te objektit te padise prej pales paditese edhe me vendimin nr.619/7 prot date 15.08.2017 krahas aktit nr.618/7 prot date 15.08.2017, ai rezulton i depozituar pertej afatit ligjor 45 ditor te parashikuar nga neni 184/g i ligjit specifik dhe neni 18 (1) i ligjit Nr. 49/2012 Ligji Per Gjykatën Administrative.

Lidhur me kete pretendim Gjykata vlereson te theksoje se pavaresisht nga marrja dijeni per te dy aktet administrative objekt kundërshtimi gjyqesor prej paditesit me 20.09.2017, padia e tij eshte e paraqitur ne kohe brenda 30 diteve duke u depozituar ne daten 20.10.2017. Per me teper qe, ne kete proces nuk ka asnje lloj pengese ligjore qe keto dy akte te ankimohen gjyqesisht ne nje padi te vetme persa kohe ne permbajtje te tyre trajtojne nje problematike me te njejtat subjekte te interesuar dhe per te njejten ceshtje qe prek te dyja palet.

Gjykata, ne kete pike, ka parasysh faktin se vendimet e kundërshtuara ne padi jane produkt i se njejtës procedure administrative te mbajtur prane Bordit te Apelimit te DPPI-se dhe kjo procedure ka qene iniciuar nga vete nderhyresi dytesor {...} s.p.a si subjekti qe ka kundërshtuar regjistrimin e markes se paditesit {...} Production. Per keto arsye, Gjykata eshte e vleresimit se te dy keto akte administrative ne trajten vendimeve te nxjerra prej Bordit te Apelimit te DPPI nr. 618/7 dhe

619/7 date 15.08.2017 duhen pranuar per tu gjykuar se bashku dhe se nuk eshte parashkruar padia lidhur me kundershimin e aktit nr.619/7 date 15.08.2017 sa kohe qe me ane te te dy akteve Bordi ka vendosur pranimin e kundershimit te regjistrimit te markes "{...}" (fjale e figure), me nr. aplikimi AL/T/2016/618 si dhe nr.aplikimi AL/T/2016/619 (fjale) dhe refuzimin e regjistrimit te markes "{...}" (fjale e figure bashke), cka ne thelb eshte e njejta gje.

Se dyti, ky trup gjykues vlereson te theksoje se u provua gjyqesisht pergjate procesit se personi i trete, nderhyresi dytesor, shoqeria "{...} S.P.A.", ne kohen kur eshte aplikuar per regjistrimin e markes se kundershuar "{...}" prej pales paditese shoqerise "{...} Production", ka qene pronar i se njejtës marke identike {...} te regjistruar ne Itali. Personi i trete arriti te argumentoje duke vertetuar me ane te provave te depozituara gjate ketij procesi gjyqesor se kjo marke eshte perdorur intensivisht ne Shqiperi dhe per kete arsye ajo ka fituar reputacion dhe emer te mire tek konsumatori shqiptar.

Lidhur me situaten faktike te shtruar per gjykim, Gjykata cmon t'i referohet kesaj baze ligjore te aplikueshme:

Neni 156 (4) i ligjit specifik nr. 9947/2008 "Per pronesine industriale" percakton se: "Te drejtat qe i njihen pronarit te markes se regjistruar i njihen edhe pronarit te markes se mirenjohur ne Republikën e Shqiperise, ne perputhje me percaktimin e shkronjes "g" te pikes 5 te nenit 143 te ketij ligji.

Neni 143 (5) (germa g) e ligjit specifik percakton: "...marka, e cila, ne daten e aplikimit per regjistrim, ose ne daten e prioritetit, ne rastet kur pretendohet per prioritet, eshte e mirenjohur ne Republikën e Shqiperise, ne kuptim te nenit 6 bis te Konventes se Parisit, te publiku i sektorit perkates, si rezultat i perdorimit, perfaqesimit, publikimit ose reklamimit.

Me tej, neni 6 bis i Konventes se Parisit ne te cilen referon norma e melartcitur shprehimisht parashikon se "shtetet anetare ndermarrin, ex officio, nese legjislacioni i tyre e lejon, ose me kerkese te pales se interesuar,, refuzimin ose shfuqizimin e regjistrimit (gregjistrimin), dhe ndalimin e perdorimit te nje marke qe perben riprodhim, imitim apo perkthim, e cila krijon konfuzion, me nje marke qe konsiderohet nga autoriteti perkates i shtetit te regjistrimit ose perdorimit si nje marke e mirenjohur ne ate shtet si rezultat i te qenurit tashme nje marke e nje personi me te drejte perfitimi nga kjo Konvente dhe e perdorur per mallra dhe sherbime identike apo te ngjashme.

Gjykata vlen te theksoje faktin se Shqiperia ka aderuar ne kete Konvente, aderim i cili ka hyre ne fuqi me 4 Tetor 1995. Keshtuqë parashikimet e Konventes jane pjese integrale e legjislacionit te brendshem dhe te detyrueshme per tu zbatuar.

Nga interpretimi literal por edhe llogjik i bazes ligjore te mesipercitur, ku edhe mbeshtetet mosmarreshja objekt gjykimi, rrjedh se pronari i nje marke te mirenjohur por te parregjistruar ne Shqiperi, sikunder eshte ne kete rast "{...} s.p.a" gezon te njejtat te drejta si pronari i nje marke te regjistruar, cka do te thote, ka te drejte te kundershtojë nje marke te mevonshme (ne faze aplikimi, apo edhe pas regjistrimit). Rezultoi e provuar ne gjykim se marka {...} {...} eshte e mirenjohur ne territorin shqiptar dhe per kete pala e trete depozitoi nje sere dokumentash qe provuan plotesimin e kriterëve ligjore te parashikuara nga neni 145 (5) (g) te ligjit specifik, dipozite kjo qe parashikon kriteret ne baze te te cilave vleresohet nje marke si e mirenjohur.

U provua ne gjykim se {...}prej shume vitesh bashkepunon dhe tregton ne Shqiperi nepermjet kontraktimit te distributoreve shqiptare si {...} shpk, A.D.E. 2011 shpk dhe Eurolab Intenacional Group shpk. Se fundmi, {...}operon ne Shqiperi, bazuar ne marreshjen e

shperndarjes te lidhur midis {...} dhe Eurolab Internacional Group shpk (dokumenta te adminstruara ne dosjen gjyqesore).

Perveç te dhenave te lidhura specifiku me perdorimin e markes {...} {...}, per te konkluduar se marka {...} {...} eshte e mirenjohur, nje faktor tjetër shtese qe nuk duhet neglizhuar eshte dhe reputacioni dhe njohja e gjere e vete emrit/markes {...}, reputacioni i te ciles, rezulton te jete i padiskutueshem ne Shqiperi. Marka {...} {...}, ben pjese te familja e markave {...}. Sipas doktrines keto marka trashegojne karakterin dallues dhe reputacionin e markes meme - ne rastin tone, markes {...}. Keshtuqë, {...} {...} ka fituar nje shkalle te caktuar njohjeje tek publiku perkates qe ne startimin e saj.

Saktesisht, u provua gjate gjykimit se marka {...} {...} ka filluar te distribuohet ne Shqiperi qe prej vitit 2012, dhe se gjate viteve 2012 dhe 2016 (gjashtemujori i pare) ne Shqiperi, {...} ka gjeneruar nje total prej 717.274 EUR nga shitja e produkteve te markes {...}. Volumi i shitjeve eshte rritur me 70% gjate vitit 2014 dhe me 120% ne vitin 2016 (gjashtemujori i pare), nderkohe te ardhurat e realizuara jane pothuajse dyfishuar. {...} {...} rezulton te jete nje nga markat e aperitiveve me shitjen me te shpejte ne tregun shqiptar, dhe perpara Shtator 2016 - kohe ne te cilen paditesi ka aplikuar per regjistrimin e markave te tij, marka {...} {...} ishte e mirenjohur ne Shqiperi, kryesisht per aperitivet. Keto fakte personi i trete {...} spa arriti t'i provoje me Deklaraten leshuar nga {...}, me kontratat e distribucionit qe {...} ka lidhur nder vite me subjekte te ndryshme shqiptare per tregtimin e aperitiveve nen marken {...} {...}, si dhe deklarata te ndryshme doganore qe tregojne importet e markes ne fjale, ne Shqiperi. Keto dokumenta gjenden te adminstruara ne dosjen e procedurave perkatese administrative, te cilat po ashtu jane te adminstruar ne dosjen gjyqesore.

Se treti, gjykata vlereson se, ne kundërshtim me ate cka pretendoi paditesi gjate gjykimit, rezultoi ne fakt te jene permbushur prej personit te trete {...} spa kriteret e vendosura nga Zyra Nderkombetare e Pronesise Intelektuale (WIPO) ne dokumentin e titulluar "Rekomandime te Perbashketa Per Mbrojtjen e Markave Te Mirenjohura" leshuar ne Shtator 1999.

Keshtu, kriteret si kohezgjatja, shtrirja dhe gjeografia e perdorimit jane faktore shume percaktues ne vleresimin nese nje marke eshte e mirenjohur apo jo. Gjithashtu, perdorimi i markes ne vende kufitare, ne territore ku fiitet e njejta gjuhe, ne territore te cilat mbuloohen nga e njejta media (television, apo media te printuara) apo ne territore te cilat kane marredhenie te ngushta tregtare mund te merren gjithashtu ne konsiderate. Prova ne lidhje me rastet e suksesshme ne zbatueshmerine e te drejtave te markes, jane po ashtu nje faktor qe duhet te mbahen parasysh ne nje vleresim te tille. Po ashtu, shkalla ne te cilen shenja eshte shfrytezuar permes licencimit, tregtimit dhe sponsorizimit, si dhe rendesia e skemave perkatese, jane indikacione te dobishme ne vleresimin e reputacionit. Ky faktor permendet ne Nenin 2 (1) (b) (6) te Rekomandimeve te WIPO-s.

Ne lidhje me sa me lart, ne vleresim te gjykates, rezulton se permbushen nje sere kriteresh te rekomanduara me dokumentin e melartcitur nga WIPO. Lidhur me kete, Gjykata cmon te referohet tek te dhenat e siguruar nga autoritetet doganore ne lidhje me importet e produkteve te {...} dhe te sjella ne gjykim prej pales se trete te cilat flasin per volume te llojit: kategoria e ujrave (kodi 2201 e vazhdim) kap shifren mbi 1,000,000 litra volum ne vit; ajo e lengjeve me sheqer (perfshire dhe aperitivet, kodi 2202 e vazhdim) ne nje mesatare vjetore prej 2,000,000 litra ne vit, dhe lengjet e frutave (kodi 2009 e vazhdim) dhe koncentratet e cajit etj (kodi 2101) me nje volum me te paket. Keto te dhena gjenden ne shkresen Nr. 13160/4 prot, date 18 Shtator 2018 leshuar nga Drejtoria e Pergjithshme e Doganave, Sektori i Analizes dhe eshte dokument i adminstruar ne dosjen gjyqesore.

Sa me lart, Gjykata vlereson se me te drejte Bordi i Apelimit te DPPI i ka gjetur kundërshtimet e

kundershtuesit {...} spa ndaj aplikimeve te markave te paditesit si te mbeshtetura ne ligj dhe prova. Bazuar ne dokumentat e paraqitura Bordi ka vleresuar marken e nderhyresit dytesor ne kete gjykim {...} {...} si te mirenjohur ne Shqiperi (qe perpara aplikimit te markave te paditesit), dhe me vendimet e tij Nr.618/7prot., dhe Nr.619/7prot., date 15 Gusht 2017 - vendime objekt gjykimi, Bordi i Apelimit me te drejte ka disponuar me pranim te kundertimeve te kundertshtuesit {...} spa duke vendosur po ashtu refuzimin e aplikimeve Nr.AL/T/2016/618 per marken figure {...} dhe Nr.AL/T/2016/619 per marken fjale {...}, te dyja te aplikuar nga paditesi.

Se katerti, gjykata vlereson te theksoje se ajo cka e legjitimon personin e trete "{...}" ne prapesimet e tij dhe cka e ben te bazuar vendimmarrjen e organit administrativ DPPI ne dy aktet e nxjerra prej tij e te kundertshtuara gjyqesisht prej paditesit La Viita Production, perbehet nga dy kushte kryesore qe duhet te permbushen ne zbatim te ligjit "Per pronesine industriale", i ndryshuar:

(1) . Marka e meparshme eshte e mirenjohur ne territorin e Republikes se Shqiperise, ne daten kur marka e kundertshtuar eshte aplikuar per rregjistrim (cka rezultoi e provuar ne gjykim dhe u bazua ne gjithe arsyetimin ligjor te bere me lart prej gjykates).

(2) . Per shkak te identitetit ose ngjashmerise midis markes se kundertshtuar dhe markes se meparshme te mirenjohur, si dhe midis mallrave dhe sherbimeve te mbrojtura nga marka, ekziston mundsia per konfuzion tek publiku perkates ne territorin perkates (Shqiperi).

Gjykata vlereson te theksoje se nese kriteri i pare u analizua hollesisht ne arsyetimin e gjykates deri ne kete pike te vendimit, vlen ne ndalemi tek i dyti, pra tek kriteri i ngjashmerise mes markave. Nga ajo cfare rezultoi gjate gjykimit, Gjykata arrin ne konkludimin se markat ne fjale jane jo vetem dukshem te ngjashme por jane thuajse identike. Nje krahasim paralel midis tyre legjitimon plotesisht pretendimet e nderhyresit dytesor "{...}" s.p.a.

Gjykata vlereson te theksoje se gjetja e ngjashmerive qofte ne njerin nga komponentet objekt krahasimi-vizual, fonetik apo konceptual perben baze te mjaftueshme per t'i konsideruar shenjat te ngjashme dhe per te passjelle mundesine e konfuzionit tek konsumatori (vlejne te permenden ne kete pike ceshtjet e GJDBE, C-251/95 Sabel BV vs.Puna AG; T-434/07 "Volvo" , gjykim i dates 02.12.2009,..etj).

Markat e pales paditese jane te inkorporuara vizualisht dhe fonetikusht tek marka e mirenjohur {...} {...}. Dhe eshte pikerisht elementi i perbashket {...} tek te dy markat i cili dominon pershtypjen e pergjithshme te markes kundertshtuese. Ne raport me elementin tjetere {...} ai ze nje raport shume te larte, rreth 90 me 10 prandaj fjala {...} cilesohet si elementi dominant i markes. Sa me lart, Gjykata vlereson se markat edhe vizualisht edhe fonetikusht jane thuajse identike.

Se pesti, sa i takon krahasimit te mallrave apo sherbimeve qe keto marka mbrojne, Gjykata vlereson te theksoje se rezultoi e provuar ne gjykim se marka e kundertshtuar, aplikimi kombetar nr.AL/T/2016/618 ka aplikuar per tu regjistruar ne klasen 32 perkatesisht per mallrat aperitive, joalkoolike. Sakaq, edhe marka kundertshtuese e nderhyresit dytesor {...} spa, sikurse u provua ne gjykim, mbulon pije jo-alkoolike dhe ne vecanti, aperitive. Nga krahasimi i mallrave ne diskutim rezultoi qarte se mallrat e markes kundertshtuese perfshihen ne kategorine e gjere te markes se kundertshtuar. Per kete shkak ato konsiderohen identike. Sa i takon pretendimit te personit te trete per keqbesim te aplikantit, paditesit, ne aplikimin e markave "{...}" fjale/fjale e figure, Gjykata vlereson se ato mbeten ne kuadrin e pretendimit, pra te paprovuara me prova shkresore.

Per sa me lart, per gjithe sa me siper hollesisht u arrestua, Gjykata vlereson se me te drejte Bordi i Apelimit te DPPI i ka gjetur kundertime e kundertshtuesit {...} spa ndaj aplikimeve te markave te paditesit si te mbeshtetura ne ligj dhe prova. Bazuar ne dokumentat e paraqitura Bordi ka vleresuar marken e nderhyresit dytesor ne kete gjykim {...} {...} si te

mirenjohur ne Shqiperi (qe perpara aplikimit te markave te paditesit), dhe me vendimet e tij Nr.618/7prot., dhe Nr.619/7prot., date 15 Gusht 2017 - vendime objekt gjykimi, Bordi i Apelimit me te drejte ka disponuar me pranim te kundershimeve te kundershuesit {...} spa duke vendosur po ashtu refuzimin e aplikimeve Nr.AL/T/2016/618 per marken figure {...} dhe Nr.AL/T/2016/619 per marken fjale {...}, te dyja te aplikuar nga paditesi. Per keto arsye, padia duhet rrezuar si e pabazuar ne ligj e ne prova.

Perfundimisht, per te gjitha sa u analizuan me siper gjykata vlereson se padia e paditesit {...} Production eshte e pabazuar ne ligj dhe ne prova dhe si e tille ajo duhet te rrezohet.

Per keto arsye

Baza Ligjore:

Gjykata, bazuar ne nenet40-42 te ligjit nr. 49/ 2012 'Pergjykatat administrative dhe gjykimin emosmarreshjeve administrative' dhe neneve126, 306-310 te KPrC-se

VENDOSI:

Vendosi:

- 1.Rrezimin e kerkese padise si te pabazuar ne prova dhe ne ligj.
- 2.Shpenzimet gjyqesore ne ngarkim te palespaditese.
3. Kunder ketij vendimi lejohet ankimi ne Gjykatën Administrative te Apelit brenda 15 diteve nga e nesermja e njoftimit te vendimit te arsyetuar paleve ndergjygjese.
4. Vendimi t'i komunikohet te gjitha palevendergjygjese dhe Avokatures se Shtetit.
Ushpall sot, ne Tirane, me 31.10.2018!

SHPENZIMET GJYQESORE

Kerkese padia	0
Taksa Gjyqesore	0
Noterizime	0
Njoftime	0
Akt ekspertimi	0
Avokat	0
Gjithsej	0

GJYQTAR:

Semiramis Hoxholli